

Ministri merr pjesë në aktivitetin “Manifestimi qendror për Diasporën”, në Kosovë



Ministri i Shtetit për Diasporën Z. Pandeli Majko mori pjesë, së bashku me Zv. Kryeministrin dhe Ministrin e Diasporës dhe Investimeve Strategjike në aktivitetin e organizuar në Komunën Skënderaj, nga Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike në Kosovë, “Manifestimi qendror për Diasporën”. Në fjalën e tij ministri Majko përshëndeti këtë nismë që i dedikohet Diasporës, si një mënyrë për të afruar më shumë me vendlindjen mërgimtarët.



QBD prezantohet në seminarin XV Mbarëkombëtar të mësuesve të Gjuhës Shqipe



Qendra e Botimeve për Diasporën prezantoi në seminarin XV Mbarëkombëtar të Mësimit Plotësues të Gjuhës Shqipe dhe Kulturës Shqiptare në Diasporë, në Prizren politikat shtetërore në ndihmesë të mësimdhënies në Diasporë, vizionin, nismat dhe punën e saj të bërë gjër më tani. Në fjalën e saj drejtoresha e Qendrës së Botimeve për Diasporën, Znj. Mimoza Hysa tha se “Qendra e Botimeve për Diasporën është një qendër e re, dhe si çdo gjë e re duket sikur i mungon historia, e shkuara dhe ka vetëm privilegjin e të ardhmes, të parashtrimit të synimeve e të dëshirave, por fakti që paraqitemi para jush sot me strategji të hartuara, me programe të strukturuar, me manuale të botuara, me projekte të nisura tashmë, është gjysma e punës. Pjesën tjetër, atë më të vështirën do ta përshkojmë së bashku”. Më tej ajo u shpreh se bashkëpunimi do të jetë baza e punës dhe gjithçka do të arrihet në të ardhmen.

Greqi, ceremonia e dorëzimit të çmimit “Ambasador i Kombit”



Në Ambasadën Shqiptare në Greqi i është dorëzuar çmimi “Ambasador i Kombit”, sipërmarrësit shqiptar në Kretë, Luli Cina. Njëpërmjet historisë së tij të suksesit, ai është shndërruar në një model për shqiptarët në Greqi, ku edhe është aktiv në promovimin e komunitetit shqiptar.

KKD, Gazmend Kapllani merr çmimin “Shqiptari i Vitit”



Organizata Kombëtare Shqiptaro-Amerikane vlerëson shkrimtarin Gazmend Kapllani me çmimin “Shqiptari i vitit”. Kapllani anëtar i Këshillit Kombëtar të Diasporës, u vlerësua dje në Chicago për punën e tij në krijimin e programit të parë ndërdisiplinor të studimeve shqiptare në Universitetin DePaul në Chicago, SHBA. Gazmend Kapllani prej vitesh është profesor në universitet dhe ka një sërë publikimesh politike, letrare si dhe ka realizuar disa kërkime shkencore. Ka kontribut aktiv në jetën politike në shtetin grek si dhe pjesëmarrje aktive në disa konferenca ndërkombëtare. Është shkrimtar i suksesshëm, dramaturg, gazetar dhe mbrojtës i të drejtave të migrantëve shqiptarë në Greqi.



KKD, “Hartford Business”, pse Visar Tasimi është i suksesshëm



Pas renditjes si një nga sipërmarrësit më të sukseshëm nën moshën 40 vjeçare në Amerikë, gazeta ekonomike “Hartford Business”, publikon një intervistë me Visar Tasimin. Përzgjedhjen si anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës për të përfaqësuar komunitetin shqiptar në Connecticut, ai e cilëson si një nga arritjet e tij më të rëndësishme. Visar Tasimi aktualisht është zëvendës president për strategjitë e shpërndarjes në kompaninë “ConnectiCare”, ku ai drejton një ekip prej 30 profesionistësh.

Foto lajm



Mësues shqiptarë në Diasporë, pjesëmarrës në Seminarin XV Mbarëkombëtar të Gjuhës Shqipe